



Duke ditur se arsimi dhe edukimi janë elemente bazë të funksionimit të shoqërisë, të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi para shoqërisë në përgjithësi dhe gjeneratave të ardhshme dhe me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet komunitetit të biznesit dhe institucioneve të Arsimit të Lartë, me datë 01.04.2021 lidhet kjo:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes:

1. **Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan**, me adresë: rr. Zija Shemsiu p.n 60000, Gjilan, të cilën e përfaqëson Prof. Dr. Bajram Kosumi, (Rektor), në njërin anë dhe
2. **Byroja Kosovare e Sigurimit**, me numër fiskal 600708575, adresë Rr.Lidhja e Pejes p.n Magjistranja Prishtinë- Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson Sami Mazreku, Drejtor Ekzekutiv, në anën tjetër.


Neni 1: Lënda e marrëveshjes

1.1.Lëndë e kësaj marrëveshje është bashkëpunimi profesional në fushën e sigurimeve. Palët në marrëveshje mund të themelojnë bashkëpunimin në organizimin e trajnimeve profesionale për sigurimet si:

- a. Bazat e sigurimeve, menaxhimin e riskut, analizën e riskut, produktet e sigurimeve jetë dhe jo-jetë, risigurimet, marketingu, kanalet e shitjes;
- b. Ligjerimi i përbashkët në trajnime për ndërmjetësues në sigurime dhe trajnimet tjera profesionale;

Neni 2: Organizimi i tryezave të rrumbullakëta

2.1. Palët në marrëveshje pajtohen që të organizojnë tryeza të përbashkëta debatuese dhe shkencore, si:



- a. Diskutimet mbi zhvillimin e tregut financiar të sigurimeve;
- b. Panelist nga industria e sigurimeve si: përfaqësues të byrosë, anëtarëve të byrosë, Banka Qendrore e Kosovës dhe Ministria e Financave;

2.2. Organizimi i konferencës vjetore për sigurimet

- a. Analiza e tregut të sigurimeve dhe impakti në ekonomi;
- b. Trendet në sigurime – zhvillimi i sistemeve dhe produkteve;
- c. Marketing;

Neni 3: Literatura për sigurimet

3.1. Palët dakordohen që të bashkëpunojnë në shkëmbimin e literaturës në fushën e sigurimeve, si:

- d. Shkëmbimi i literaturës profesionale për sigurimet (librat e botuar, publikimet-revistat, praktikat e mira);
- e. Përmirësimi i buletinit të byrosë me tema aktuale të zhvillimit të sigurimeve në Europë;
- f. Ofrimi i materialeve profesionale për studentë dhe stafin e kompanive të sigurimit;
- g. Shpërndarja e Revistes i-Sigurimet, tek studentët e Universitetit “Kadri Zeka” në formë elektronike, botim i Byrosë Kosovare te Sigurimit.

Neni 4: Praktika profesionale dhe ligjerata të përbashkëta

4.1. Palët pajtohen të mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale të studentëve si:

- a. Bashkëpunimi në përbushjen e programeve akademike për studentë me kryerjen e punës praktike pranë kompanive të sigurimit anëtarë të byrose;
- b. Strukturimi i funksionimit të programit të praktikës (caktimi i numrit të studentëve, periudha, etj);
- c. Pajisja me çertifikatë për kryerjen e punës praktike për periudhën përkatëse;



4.2. Ligjeratat e përbashkëta për studentë

- d. Njoftimi mbi aspektin praktik të sigurimeve, për kontratat e sigurimeve vullnetare (shëndet, jetë, pronë, pasuri) – marrjen në sigurim, vlerësimi i riskut, etj.;
- e. Trajtimi i dëmeve në sigurime.

Neni 5: Trajnimet për ndërmjetësues në sigurime

5.1. Palët pajtohen të organizojnë mbajtjen e trajnimeve dhe tryezave për ndërmjetësues në sigurime.

5.2. Nëse Byroja organizon trajnime të tilla, do të shfrytëzojë sallat e Universitetit “Kadri Zeka”. Orari dhe salla përkatëse e organizimit të trajnimeve do të caktohet me marrëveshje me Rektorin e Universitetit.

Neni 6: Të drejtat dhe detyrimet e palëve

6.1. Palët në marrëveshje marrin përgjegjësi për zbatimin e plotë të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit.

6.2. Palët në marrëveshje pajtohen që gjatë implementimit të kësaj marrëveshje të mos çenojnë veprimtarinë e njëra-tjetrës.

Neni 7: Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje

7.1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet për afat të pacaktuar, dhe do të jetë në fuqi derisa palët të njoftojnë njëra tjetren për ndërprerjen.

7.2. Secila palë ka të drejtë të kërkojë ndërprerjen e bashkëpunimit njëanshëm me njoftim paraprak prej 6 muajsh.



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Pranuar nga data: 01. 04. 2021			
Nr. Akti	Nr. Akti	Nr. Akti	Nr. Akti
	011	750	



Neni 8: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet eventuale ti zgjidhin me mirëkuptim përmes bisedimeve, e kur kjo nuk është e mundur, çështja mund ti adresohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 9: Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje përmban gjithsejt 9 nene, dhe u nënshkrua me datë 01.04.2021 nga palët kontraktuese në 4 kopje identike, nga 2 kopje për secilën palë.

Nënshkruesit e marrëveshjes

z. Bajram KOSUMI

Rektor i Universitetit Publik

"Kadri Zeka" Gjilan

z. Sami MAZREKU

Drejtor Ekzekutiv

Byroja Kosovare e Sigurimit

